# DËSHMI ARKIVI

**A-464960**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Këlliçi: Jemi kundër bojkotit, nuk është zgjidhja jonë. Ja agjenda e opozitës |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/kellici-jemi-kunder-bojkotit-nuk-eshte-zgjidhja-jone-ja-agjenda-e-opozi-i588048` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 08:12:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 08:30:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3f0398d343029f13ec016139cabb2d22c329a6eb913ef34d615110be1f9772ab` |
| TEKSTI | `1e9022d968616a12964d4ef41d84a19147fb000812bc39c416d9783e1bc6f7b9` |
| PAMJA | `59c165fb600d9d6d190aa862537d944e97110d503dde8557848539d66592ad39` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `97a96e4dc47120d44d38af582695c4e6b6ef421cb97c21abb98f4bc7107712a2` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9a6b20a4f7bca7d38b85ed38d229f05609a1ca606edde02ba3c9e62d673a221c` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/97a96e4dc47120d44d38af582695c4e6b6ef421cb97c21abb98f4bc7107712a2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Këlliçi: Jemi kundër bojkotit, nuk është zgjidhja jonë. Ja agjenda e opozitës


TemA

24 Shtator 2026, 10:30Politika TEMA




Nënkryetari i Partisë Demokratike, Belind Këlliçi ka deklaruar në emisionin "Trialog" të Alba Alishanit në RTSH24 se forumi i lartë i partisë ka vendosur të hedhë poshtë çdo ide për bojkot parlamentar dhe të fokusojë tërësisht agjendën e saj në skandalet e fundit.

Sipas Këlliçit, dy mbledhjet e sotme – ajo e grupit parlamentar dhe ajo e kryesisë – kanë zgjatur gjithsej rreth gjashtë orë e gjysmë dhe kanë pasur në qendër zhvillimet e dy javëve të fundit.

"*Sapo kemi mbaruar 10 minuta më parë mbledhjen e dytë, ka qenë mbledhja e kryesisë së Partisë Demokratike. Kemi patur dy mbledhje që kanë zgjatur në total rreth gjashtë orë e gjysmë me të dyja këto forume të larta.*

*Grupin parlamentar të Partisë Demokratike kemi nisur në orën 13 dhe në orën 18 nisëm mbledhjen e kryesisë së Partisë Demokratike, ku sigurisht java e fundit apo dyjavëshi i fundit ka qenë kryefjala",* u shpreh Këlliçi.

Ai vuri në dukje se Partia Demokratike nuk ka ndërmend të bojkotojë seancat plenare ndërsa shpjegoi se cila do të jetë agjenda ditën e nesërme në Kuvend.

"*Ne kemi pasur një debat shumë të gjatë. Është dakordësuar që kjo histori nuk mundet të vazhdojë më 'business as usual'. Patjetër ne jemi kundër bojkotit. Është hedhur ideja, janë hedhur të gjitha opsionet në tryezë, në tavolinë. Pa diskutim ne e kemi sanksionuar dhe në statut tashmë që bojkoti nuk do të jetë zgjidhja jonë dhe nuk do të jetë më kurrë kundërpërgjigja politike e Partisë Demokratike.*

*Duke nisur nga dita e nesërme do të ketë vetëm një axhendë në rendin e ditës në parlament që do të jetë skandali më i fundit me Shërbimin Informativ Shtetëror. Kjo nuk është çështje individësh, është çështje institucionesh.*

*Zyrtarisht janë gjunjëzuar institucionet më të larta të shtetit para këmbëve të krimit të organizuar dhe të grupeve të strukturuara kriminale dhe kjo është një histori që do duhet të ishte shoqëruar që në momentin e parë që u bë publike me dorëheqjen e kryeministrit*", tha Këlliçi.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Kuvendi mblidhet sot në seancë plenare, dy interpelanca urgjente dhe dy projektligje në rendin e ditës]

07:33 Politika

“Të gjithë mbështetësit tanë të ngrihen në këmbë”/ Berisha përjashton opsionin e bojkotit të Parlamentit: Do të ishte avantazh për Ramën

19:25 Politika / 27 komente

Komisioni Europian: Negociatat me Shqipërinë për në BE drejt mbylljes në dhjetor 2027

18:35 Politika / 20 komente

Kur James Bondi kthehet në Menekshe: Telendisja në telenovelë turke, e një spy story


18:05 Politika / 71 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.